



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Ballsh, më ____ . ____ . 2022

Lënda: **Formulari i Njoftimit të Fituesit**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË
(për publikim në SPE dhe buletin e njoftimeve publike)

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
BASHKIA MALLAKASTËR

Data 27.06.2022

Drejtuar: **“INSTITUTI DEKLIADA - ALB” shpk**, me NIPT K71606006A, me adresë ushtrimi të aktivitetit sipas QKB: Njësia Bashkiake nr.5, rruga “MילוTutulani”, ndërtesa 4, hyrja 10, apartamenti 6, 1019, TIRANË

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur e thjeshtuar”**

Numri i referencës së Lotit 4: **REF-30123-05-20-2022**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Loti 4 “Projektim me objekt: “Ndërtim i shkollës “Gjok Doçi” Fratar”**, me fond limit **1,977,885** (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e pesë) **Lekë pa TVSH**, me afat 30 (tridhjetë) ditë.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.69, datë 30 Maj 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori Ekonomik (OE) “GRAMA” shpk**, me NIPT J77304712J, me ofertë ekonomike në shumën prej **1,850,000** (një milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) **lekë pa TVSH**.
- 2. Operatori Ekonomik (OE) “INSTITUTI DEKLIADA-ALB” shpk**, me NIPT K71606006A, me ofertë ekonomike në shumën prej **1,569,267** (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**.

3. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “LORENCO & CO” shpk**, me NIPT J61903071B & **“SPHAERA” shpk**, me NIPT J81809003U, me ofertë ekonomike në shumën prej **1,568,646** (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e dyzetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**.
4. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “M.A.G PARTNERS” shpk**, me NIPT M11501019A & **“STUDIO ARCHIMED” shpk**, me NIPT L122120270 & **“A & E” shpk**, me NIPT K49322502N, me ofertë ekonomike në shumën prej **1,568,646** (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e dyzetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**.
5. **Operatori Ekonomik (OE) “NET-GROUP” shpk**, me NIPT L72023002P, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **1,579,268.29** (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë njëzetë e nëntë) **lekë pa TVSH**.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm, përkatësisht për arsyet:

1. **OE “GRAMA” shpk**, me NIPT J77304712J, me ofertë ekonomike në shumën prej **1,850,000** (një milion e tetëqind e pesëdhjetëmijë) **lekë pa TVSH**, **nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe **Oferta e tij nuk është e vlefshme** për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:
 - Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.2. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim për Lotin 4, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi referuar Licencës në Projektim N.2841/12, të shoqërisë, rezulton se nuk disponon kategoritë “2.b – 2.Qendra tregtare; objekte social-kulturore; ... Objekte arsimore.”, “4.j – Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale..” dhe “12.b – Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.” dhe rrjedhimisht nga “GRAMA” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.
2. **BOE “LORENCO & CO” shpk**, me NIPT J61903071B & **“SPHAERA” shpk**, me NIPT J81809003U, me ofertë ekonomike në shumën prej **1,568,646** (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e dyzetë e gjashtë) **lekë pa TVSH**, **nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim** të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe **Oferta e tij nuk është e vlefshme** për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi gjatë kontrollit dhe verifikimit të dokumentacionit fizik të paraqitur (si ofertues i kualifikuar i pari në vlerësimin e datës 17.06.2022), nuk arrin të provojë përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në Dokumentat Standarte të Tenderit (DST), pasi ka këto mangësi:
 - Nga anëtari i BOE “SPHAERA” shpk nuk është dorëzuar vërtetimi për pagesën e energjisë elektrike të deklaruar sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, gjë e cila passjell mospërmbushjen e pikës 1, gërma “e”, të Krieteve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të Shtojcës 8, të DST.
 - Nga anëtari i BOE “LORENCO & CO” shpk nuk është dorëzuar vërtetimi për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore të deklaruar sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, gjë e cila passjell mospërmbushjen e pikës 1, gërma “dh”, të Krieteve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të Shtojcës 8, të DST.
 - Nga verifikimi i dokumentave të dorëzuara fizikisht nga BOE “LORENCO & CO” shpk & “SPHAERA” shpk, rezulton se nuk përmbushet pika 2.3.4. e Kapacitetit teknik, te Kriteret e

Veçanta për Kualifikim për Lotin 4, të Shtojcës 8, të DST, pasi nuk vërtëton me dokumentacion të rregullt se ka të punësuar si pjesë të stafit, të paktën për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit specialistët e kërkuar arkitekt dhe inxhinier ndërtimi, shoqëruar me kontratat noteriale të punës të vlefshme, diplomat, cv, licencat profesionale në projektim.

- Gjithashtu, gjatë verifikimit të dokumentacionit fizik të dorëzuar nga BOE “LORENCO & CO” shpk & “SPHAERA” shpk, si dhe riverifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se nuk përmbushet as pika 2.3.2. e Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim për Lotin 4, të Shtojcës 8, të DST, pasi asnjë prej anëtarëve të BOE nuk ka në licencën profesionale të shoqërisë në projektim kategorinë “2.b – 2.Qendra tregtare; objekte social-kulturore; ... Objekte arsimore.” dhe kategorinë “12.b – Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.”.

3. BOE “M.A.G PARTNERS” shpk, me NIPT M11501019A & “STUDIO ARCHIMED” shpk, me NIPT L12212027O & “A & E” shpk, me NIPT K49322502N, me ofertë ekonomike në shumën prej 2,100,000 (dymilion e njëqindmijë) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe Oferta e tij nuk është e vlefshme për të kaluar në fazën e krahasimit dhe vlerësimit të ofertave, për të përcaktuar ofertën më të mirë, sipas kriterit “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim”, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.2.1. të Kapacitetit ekonomik dhe financiar, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim për Lotin 4, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), konstaton se BOE ka marrë pjesë dhe ka ofertuar në të katërta Lotet e procedurës objekt prokurimi dhe nga kryesuesi i BOE “M.A.G PARTNERS” shpk, i cili ka marrë përsipër të kryejë 50% të shërbimit të projektimit për të katërta Lotet, nuk plotësohet kjo kërkesë. Kjo pasi, vlera e xhiros së kryesuesit të BOE “M.A.G PARTNERS” shpk për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhej të ishte në një vlerë jo më të vogël se 50% e 40 % të shumatores së vlerave limit për lotet që ka ofertuar, pra në vlerën 1,884,690 lekë, ndërkohë që xhiro e realizuar nga “M.A.G PARTNERS” shpk është në vlerën 429,378 lekë. Në kërkesën e e përcaktuar sipas pikës 2.2.1., ndër të tjera është përcaktuar se: *“Në rast se operatori ekonomik oferton në më shumë se një lot, vlera e xhiros duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % e shumatores së vlerave limit për lotet që oferton.”*. Ndërsa në pikën 3, të nenit 88, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”*. Rrjedhimisht, referuar sa më sipër, nga BOE “M.A.G PARTNERS” shpk & “STUDIO ARCHIMED” shpk & “A&E” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.
- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës 2.3.1. të Kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim për Lotin 4, të Shtojcës 8, të Dokumentave Standarte të Tenderit, pasi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), konstaton se BOE ka marrë pjesë dhe ka ofertuar në të katërta Lotet e procedurës objekt prokurimi dhe nga kryesuesi i BOE “M.A.G PARTNERS” shpk, i cili ka marrë përsipër të kryejë 50% të shërbimit të projektimit për të katërta Lotet, nuk plotësohet kjo kërkesë. Kjo pasi, vlera për shërbime të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga kryesuesi i BOE “M.A.G PARTNERS”

shpk, duhej të ishte në një vlerë jo më të vogël se 50% e 20 % të shumatores së vlerave limit për lotet që ka ofertuar, pra në vlerën 942,345 lekë, ndërkohë që shërbimi i mëparshëm me objekt “Shërbim projektimi “Rikonstruksioni i linjes 110 kV Ulez–Burrel”, i realizuar nga “M.A.G PARTNERS” shpk është në vlerën 250,000 lekë. Në kërkesën e e përcaktuar sipas pikës 2.3.1., ndër të tjera është përcaktuar se: *“Në rast se operatori ekonomik oferton në më shumë se një lot, vlera e shërbimeve të mëparshme të ngjashme të realizuar gjatë tre viteve të fundit, duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% e shumatores së vlerave limit për lotet që oferton.”*. Ndërsa në pikën 3, të nenit 88, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”*. Rrjedhimisht, referuar sa më sipër, nga BOE “M.A.G PARTNERS” shpk & “STUDIO ARCHIMED” shpk & “A&E” shpk, nuk plotësohet kjo kërkesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: **“INSTITUTI DEKLIADA - ALB” shpk**, me NIPT K71606006A, me adresë ushtrimi të aktivitetit sipas QKB: Njësia Bashkiake nr.5, rruga “Milito Tutulani”, ndërtesa 4, hyrja 10, apartamenti 6, 1019, TIRANË, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej **1,569,267** (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Qerim Ismailaj